



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 17, datë 30.1.2020

PËR

**DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR.152, DATË 1.10.2018,
TË KRYEMINISTRIT, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS
DHE TË ORGANIKËS SË AGJENCISË SË MENAXHIMIT
TË BURIMEVE UJORE”**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.152, datë 1.10.2018, të Kryeministrit, bëhen këto ndryshime:

1. Në skemën 2, që përmendet në pikën 2, të bëhen këto ndryshime:

- a) Në nënndarjen 5.1 të shtohet një pozicion “specialist (arkiv-protokoll), kategoria IV-b”;
- b) Numri i punonjësve të ndarjes 5.1 të bëhet 6 punonjës;
- c) Numri i punonjësve të ndarjes 5 të bëhet 10 punonjës.

2. Pika 8 të ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Numri i punonjësve të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore të jetë, gjithsej, 83 veta.”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

NR.PROT. 268/1
DATË 30.1 2020

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE
UJORE
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

